



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 997/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “MID Group” L.L.C., me seli në Prishtinë, rr. “Sylë Hotla”, Taukbashqe, nr. 9, kundër debitorit “Higjiena” Sh.A., me seli në Deçan, rr. “Bjeshkët e Deçanit”, p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.B., avokate me seli në Deçan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 165/2023 i datës 15.06.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Eset Murati nga Prishtina, jashtë seancës me datën 15.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Higjiena” Sh.A., ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 165/2023 i datës 15.06.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “MID Group” L.L.C, me datë 15.06.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 165/2023, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit Faturë nr. 09082021-01, e datës 09.08.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 18,089.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e rënies në vonesë me datë 26.08.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Debitori, përmes përfaqësueses së autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor, me arsyetimin se në faturën në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor nuk jepet përshkrimi i shërbimeve që kreditori ka kryer për debitorin. Ka shtuar se gjykata duhet të ketë parasysh mbi çfarë punë juridike është bërë faturimi pasi që nga

kontrata për shërbime e lidhur ndërmjet Shoqatës për Pastërti dhe Ambient Pamkos dhe NL Higjiena sh.a të autorizuar si autoritet kontraktues nga Komuna e Deçanit, bazë për kontratë është memorandumi mirëkuptimi, ku në bazë të tij është përcaktuar se debitori do të jetë pjesëmarrëse në realizimin e projekteve në lartësi prej 3,000.00 €, ndërsa pjesa tjetër prej 55,000.00 € ka qenë pjesë të cilën me anë të kësaj marrëveshje është dashur që Komuna e Deçanit ta deponojë në llogarinë e NPL Higjiena, andaj debitori nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje, për faktin se shumën prej 3,000.00 € e ka përmbushur ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ashtu që urdhrin përmbarimor ta lë jashtë fuqie.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se i mungon legjitimiteti pasiv, kreditori me debitorin kanë lidhur kontratën për shërbime me shenjën E003-08-21, ku fatura për shërbimet e kryera i është dorëzuar debitorit me datë 09.08.2022 dhe i njëjti nuk ka bërë denoncimin e faturës. Ka shtuar se debitori në prapësimin e tij nuk ka ofruar prova me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij, andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 09082021-01, e datës 09.08.2021, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në

përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përbarimit pasi që është e përshtatshme për përbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se i njëjti nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje përbarimore pasi që me memorandumin e mirëkuptimit të lidhur në mes të debitorit dhe Komunës së Deçanit është paraparë debitori të alokoj mjete vetëm në vlerë prej 3,000.00 EUR ndërsa pjesën tjetër do ta përmbush Komuna e Deçanit, por që në rastin konkret, objekt shqyrtimi është vetëm përshtatshmëria e faturës mbi bazën e të cilës është lejuar përbarimi, dhe e cila faturë derivon nga kontrata për shërbime nr. prot E 002-08-21 e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, ku debitori si autoritet kontraktues, me nenin 8 të kësaj kontrate ka marrë për obligim pagesën e faturës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i saj.

Debitori, faturën në fjalë e ka pranuar pa asnjë kundërshtim, që nënkupton se është pajtuar me detyrimin që derivon nga kjo faturë, ndërsa pretendimet e natyrës materialo –juridike se debitori së bashku me Komunën e Deçanit kanë qenë në bashkëfinancim të projektit të kryer nga kreditori, nuk janë objekt shqyrtimi i kësaj procedure përbarimore, por që të njëjtat debitori mund t'i paraqes në kontest të rregullt juridik civil.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 997/23, datë 15.01.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.